



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute Public Health of Kosova

SËMUNDJET KRONIKE JO-NGJITËSE NË KOSOVË

Analizë krahasuese 2023–2024

Prishtinë, 2026

RAPORT ANALITIK

**Sëmundjet Kronike Jongjitëse në Kosovë
Analizë krahasuese e të dhënave 2023-2024**

Përgatitur nga:

**Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
Departamenti i Epidemiologjisë-Divizioni për Sëmundje Kronike Jongjitëse**

Prishtinë, 2026

v.2

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1.HYRJE	5
2.METODOLOGJIA	5
3.REZULTATET	6
3.1. Trendi i përgjithshëm 2023-2024	6
3.2. Struktura sipas diagnozave.....	9
3.2.1. Hipertensioni arterial.....	11
3.2.2. Diabeti.....	12
3.2.3. Sëmundja iskemike e zemrës.....	15
3.2.4. Sëmundjet kronike respiratore.....	17
3.2.5. Insuficienca kronike e veshkave.....	21
3.2.6. Çrregullimet mendore.....	22
3.3. Shpërndarja gjeografike e rasteve	24
4. SËMUNDJET MALINJE	28
5. DISKUTIMI	39
6. KONKLUZIONE	40
7. REKOMANDIME	41
8. PËRFUNDIMI	42
9. REFERENCAT	43

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Sëmundjet Kronike Jongjitime (SKJN) përbëjnë shkakun kryesor të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë në Kosovë dhe paraqesin sfidë të vazhdueshme për sistemin shëndetësor. Analiza e të dhënave të raportuara nga nivelet e kujdesit shëndetësor në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës për vitet 2023 dhe 2024 tregon një rritje të konsiderueshme të rasteve të regjistruara.

Në vitin 2023 janë raportuar 41258 raste të SKJN, ndërsa në vitin 2024 janë raportuar 43539 raste. Kjo paraqet një rritje prej 2281 rasteve apo 5.5%.

Hipertensioni esencial mbetet diagnoza dominante, duke përbërë mbi gjysmën e rasteve në të dy vitet. Diabeti mellitus dhe sëmundjet kronike obstruktive të mushkërive (COPD) paraqesin, gjithashtu, pjesë të konsiderueshme të sëmundshmërisë së përgjithshme, sikurse edhe sëmundjet malinje.

Sa i përket shpërndarjes gjeografike, rritja e rasteve të SKJN nuk është homogjene në të gjitha komunat, dhe paraqet karakteristika të dallueshme territoriale dhe demografike, ku Gjakova tregon një rritje të theksuar dhe disproporcionale, Prishtina paraqet stabilitet në nivel të lartë, Mitrovica shënon një rritje të moderuar të rasteve, derisa komunat si Ferizaj e Prizreni shënojnë një rënie të lehtë të rasteve.

Sipas grup-moshave, sëmundjet kronike jo-ngjitëse dominohen nga grup-mosha 60+, e cila përbën mbi 70% të rasteve në të dy vitet.

Rritja e rasteve mund të reflektojë një kombinim të faktorëve: rritje reale e prevalencës, përmirësim i raportimit, rritje të qasjes në shërbime shëndetësore dhe intensifikim të diagnostikimit në kujdesin parësor.

Gjetjet e këtij raporti theksojnë nevojën për forcim të parandalimit, depistimit të hershëm dhe menaxhimit të integruar të SKJN në nivel nacional.

1. HYRJE

Sëmundjet kronike jo-ngjitëse përbëjnë shkakun kryesor të vdekshmërisë në nivel global dhe përfaqësojnë mbi 70% të vdekjeve në botë¹. Ato përfshijnë kryesisht sëmundjet kardiovaskulare, diabetin, sëmundjet kronike respiratore dhe sëmundjet malinje. Në Kosovë, tranzicioni demografik, urbanizimi, ndryshimet në stilin e jetesës dhe ekspozimi ndaj faktorëve të rrezikut (duhanpirja, ushqyerja jo e shëndetshme, obeziteti, inaktiviteti fizik) kanë kontribuar në rritjen e incidencës së SKJN.

Qëllimi i këtij raporti është të analizojë trendin e raportimit të SKJN për periudhën 2023–2024, të identifikojë diagnozat kryesore dhe të vlerësojë shpërndarjen gjeografike të rasteve sipas komunave.

2. METODOLOGJIA

Analiza bazohet në të dhënat rutinë të raportuara nga institucionet e kujdesit shëndetësor në nivel nacional për vitet 2023 dhe 2024, sipas klasifikimit ICD-10, të mbledhura nga Departamenti i Statistikave Shëndetësore i IKSHPK-së, përmes sistemit rutinë të raportimit përmes Regjistrit të Sëmundjeve Kronike (masovike) jongjitëse. Në mënyrë specifike analizon dhjetë diagnozat më të raportuara nga SKJN. Të dhënat e nxjerra nga Vjetari i Statistikave Shëndetësore: Raporti i Sëmundjeve Masovike Jongjitëse për periudhën Janar-Dhjetor 2023 dhe Raporti i Sëmundjeve Masovike Jongjitëse për periudhën Janar-Dhjetor 2024 përfshijnë:

- Numrin total të rasteve të raportuara
- Diagnozatat sipas klasifikimit ICD
- Shpërndarjen sipas komunave

Analiza është kryesisht deskriptive dhe krahasuese ndërmjet dy viteve. Kufizimet përfshijnë mundësinë e nën-raportimit, ndryshime në praktikën e raportimit dhe mungesën e standardizimit sipas madhësisë së popullsisë.

¹ World Health Organization (WHO). Noncommunicable diseases progress monitor 2025, [ëëë.ëho.int/publications/i/item/9789240105775](https://www.who.int/publications/i/item/9789240105775)

3. REZULTATET

3.1 Trendi i përgjithshëm 2023–2024

Në vitin 2023 janë raportuar 41258 raste të SKJN, ndërsa në vitin 2024 janë raportuar 43539 raste. Kjo paraqet një rritje prej 2281 rasteve apo 5.5%.

Gjatë vitit 2023, 61.19% të rasteve të raportuara janë të gjinisë femërore (25224 nga 41258 raste në total), kurse 34% apo 16034 raste janë të gjinisë mashkullore. Në vitin 2024, nga 43539 raste të raportuara, të gjinisë femërore janë 26021 apo 59.8%, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 17518 raste apo 40.2%.

Rritja është më e theksuar në grup-moshat 60+ vjeç, ndërsa diagnozat dominuese janë Hipertensioni arterial HTA (I10), Diabeti tip 2 (E11) dhe Infarkti akut i miokardit (I21).

Struktura gjinore tregon një trend të qëndrueshëm: femrat dominojnë në prevalencën totale të sëmundjeve, ndërsa meshkujt kanë peshë më të madhe në sëmundjet akute kardiovaskulare.

Rritja më e theksuar në grupmoshat mbi 50 vjeç (dominon grup-mosha 65-69 vjeç), reflekton plakjen e popullsisë dhe ekspozimin e zgjatur ndaj faktorëve të rrezikut.

Ky trend rritës sugjeron intensifikim të rasteve të SKJN, por njëkohësisht mund të reflektojë përmirësim të sistemit të raportimit dhe diagnostikimit.

Sa u përket sëmundjeve malinje, të dhënat e regjistruara për vitet 2023 dhe 2024 tregojnë se sëmundjet malinje vazhdojnë të përbëjnë një ngarkesë të rëndësishme për shëndetin publik në Kosovë.

Gjatë vitit 2023 janë regjistruar 4165 raste të reja të sëmundjeve malinje, ndërsa në vitin 2024 janë regjistruar 3644 raste të reja, duke shënuar një ulje prej rreth 12.5% të incidencës. Shpërndarja sipas gjinisë është pothuajse e balancuar në të dy vitet, megjithëse femrat përbëjnë pjesën më të madhe të rasteve në të dy vitet (rreth 55%), çka lidhet kryesisht me dominimin e kancerit të gjirit dhe mbijetesën më të gjatë në krahasim me disa lloje të tjera të kancerit.

Sipas grupmoshave, shumica e rasteve të sëmundjeve malinje paraqiten në moshat mbi 50 vjeç, me rritje të dukshme të incidencës në grupmoshat 50–69 dhe mbi 70 vjeç. Kjo reflekton lidhjen e fortë të kancerit me plakjen e popullsisë dhe rritjen e jetëgjatësisë.


Tabela 1: Rastet e Sëmundjeve Kronike Jongjtitëse, të raportuara për periudhën Janar- Dhjetor 2023 dhe Janar-Dhjetor 2024, sipas grup-moshës dhe gjinisë

Grup Mosha	2023				2024			
	Gjinia		N	%	Gjinia		N	%
	F	M			F	M		
0-4	30	30	60	0.15%	55	48	103	0.24%
5-9	17	32	49	0.12%	24	41	65	0.15%
10-14	33	25	58	0.14%	37	33	70	0.16%
15-19	49	70	119	0.29%	51	68	119	0.27%
20-24	88	105	193	0.47%	81	111	192	0.44%
25-29	117	165	282	0.68%	75	113	188	0.43%
30-34	154	179	333	0.81%	139	176	315	0.72%
35-39	283	265	548	1.33%	210	268	478	1.10%
40-44	499	459	958	2.32%	456	467	923	2.12%
45-49	1124	739	1863	4.52%	985	761	1746	4.01%
50-54	2016	1208	3224	7.81%	1921	1207	3128	7.18%
55-59	3142	1822	4964	12.03%	3154	1975	5129	11.78%
60-64	4133	2437	6570	15.92%	4268	2716	6984	16.04%
65-69	4704	2978	7682	18.62%	4918	3102	8020	18.42%
70-74	4231	2577	6808	16.50%	4481	2862	7343	16.87%
75-79	2695	1677	4372	10.60%	2961	1943	4904	11.26%
80+	1839	1244	3137	7.60%	1938	1444	3382	7.77%
Panjohur	16	22	38	0.09%	267	182	450	1.03%
Total	25224	16034	41258	100.00	26021	17518	43539	100.00

Bazuar në të dhënat nga tabela 1, rritja e rasteve prej 5.5% nga viti 2023 në vitin 2024, sugjeron për plakje të popullsisë, rritje të mbijetesës nga sëmundjet kronike dhe përmirësim relativ i raportimit gjatë vitit 2024.

Tabela 2. Krahasimi i SMJN 2023 vs 2024

0	2023	2024	Ndryshimi
Raste totale SKJN	41258	43539	↑ +5.5%
Femra (%)	61.10%	~59.8%	↓ lehtë
Meshkuj (%)	38.90%	~40.2%	↑ lehtë
Grupmosha 60+	Dominante	Më dominante	↑ lehtë



Grafiku 1: Struktura e rasteve të Sëmundjeve Kronike Jongjitëse, sipas gjinisë (2023 dhe 2024)


3.2. Struktura sipas diagnozave

Hipertensioni esencial përbën diagnozën kryesore në të dy vitet, duke dominuar qartë strukturën e raportimit. Diabeti mellitus paraqet grupin e dytë më të shpeshtë, ndërsa sëmundjet kronike respiratore (COPD) dhe astma, zënë një pjesë të konsiderueshme të rasteve.


Dominimi i hipertensionit sugjeron prevalencë të lartë të faktorëve të rrezikut kardiovaskular në popullatë.

Të dhënat e raportuara tregojnë se gjatë vitit 2023, numri më i madh i rasteve i takojnë Hipertensionit arterial primar (I10) me 49.6%; pastaj Diabetit tip 2 (E11) me 23.6%; vijon Diabeti tip 1 (E10) me 8.3%; Angina Pectorale (I20) me 4.2%; Sëmundja iskemike kronike e zemrës (I25) me 3.6%; Skizofrenia (F20) me 2.6%; Bronkiti kronik i paspecifikuar (J42) me 2.4%; Insuficienca kronike e veshkave (N18) me 1.7%; Astma bronkiale (J45) me 1.2% dhe Epizoda e rëndë depresive me simptomë psikotike (F32.3) me 0.5%.

Gjatë vitit 2024 ndërkaq, numri më i madh i rasteve të raportuara u takojnë diagnozave si në vijim: Hipertensioni arterial primar (I10) me 49.2%; Diabeti tip 2 (E11) me 26.9%; Diabeti tip 1 (E10) me 6.2%; Infarkti akut i miokardit (I21) me 5.4%; Bronkiti kronik i paspecifikuar (J42) me 2.7%; Insuficienca kronike e veshkave (N18) me 2.4%; Skizofrenia (F20) me 1.4%; Sëmundjet e tjera obstruktive kronike të mushkërive (J44) me 1.35%; Angina Pectorale (I20) me 0.9% dhe Astma broniale (J 45) me 0.8%.



Grafiku 2: Rangu i diagnozave të Sëmundjeve Kronike Jongjitëse të raportuara për periudhën Janar-Dhjetor 2023 te të gjitha rastet



Grafiku 3. Rangu i diagnozave të Sëmundjeve Kronike Jongjitëse të raportuara për periudhën Janar-Dhjetor 2024, te të gjitha rastet

Tabela 3. Krahasimi i diagnozave kryesore të Sëmundjeve Kronike Jongjitëse 2023–2024

Diagnoza	2023	2024	Ndryshimi
Hipertension arterial (I10)	20 472	21425	↑- rritje e lehtë e rasteve
Diabet mellitus tip 2 (E11)	9723	11729	↑↑- rritje e theksuar e rasteve
Diabet mellitus tip 1 (E10)	3410	2681	↓ -rënie e lehtë e rasteve
Infarkt akut i miokardit (I21)	1800*	2366	↑↑ -rritje e theksuar e rasteve
Bronkit kronik (J42)	997	1164	↑- rritje e lehtë e rasteve

Bazuar në diagnozat kryesore të raportuara të SKJN 2024, vërehet një numër i përafërt i rasteve bazuar në strukturën e raportimit të vitit 2023. Ndërkohë që “Raporti i Sëmundjeve Masovike Jo-ngjitëse për vitin 2023”, diagnozat e sëmundjeve të raportuara për Janar -Dhjetor 2023 i ka grupuar në total për të dy gjinitë, në “Raportin e Sëmundjeve Masovike Jo-ngjitëse 2024”, rastet e raportuara janë analizuar edhe sipas gjinisë dhe, ajo që veçohet është se te gjinia femërore katër diagnozat e para që dominojnë janë: Hipertensioni arterial primar, Diabeti tip 2, Diabeti tip 1 dhe Infarkti akut i miokardit, ndërsa te meshkujt dominojnë: Hipertensionin arterial primar, Diabeti tip 2, Infarkti i miokardit dhe Diabeti tip 1. Përqindja e rasteve me infarkt akut të miokardit rezulton më e lartë te meshkujt 9.7%, në raport me femrat 2.6%.

3.2.1 Hipertensioni arterial HTA (I10)

Tabela 4: Rastet e Hipertensionit primar arterial (I10), të raportuara për periudhën Janar Dhjetor 2023 dhe Janar-Dhjetor 2024, sipas grupmoshës dhe gjinisë

Grup Moshë	Hipertensioni (I10)							
	2023				2024			
	Gjinia		N	%	Gjinia		N	%
	F	M			F	M		
0-4	-	-	-	-	-	-	-	-
5-9	-	-	-	-	-	-	-	-
10-14	-	-	-	-	-	-	-	-
15-19	3	9	12	0.06%	3	2	5	0.02%
20-24	9	9	18	0.09%	7	9	16	0.07%
25-29	26	23	49	0.24%	14	25	39	0.18%
30-34	48	41	89	0.43%	47	43	90	0.42%
35-39	106	86	192	0.94%	93	73	166	0.77%
40-44	245	170	415	2.03%	207	171	378	1.76%
45-49	622	288	910	4.45%	583	301	884	4.13%
50-54	1167	494	1661	8.11%	1135	511	1646	7.68%
55-59	1784	744	2528	12.35%	1850	815	2665	12.44%
60-64	2284	1048	3332	16.28%	2447	1189	3636	16.97%
65-69	2565	1336	3901	19.06%	2731	1349	4080	19.04%
70-74	2332	1192	3524	17.21%	2385	1302	3687	17.21%
75-79	1432	793	2225	10.87%	1536	898	2434	11.36%
80+	1000	611	1611	7.87%	995	669	1664	7.77%
Panjohur	3	2	5	0.02	15	20	35	0.16
Total	13626	6846	20472	100.00	14048	7377	21425	100.00

Hipertensioni arterial primar paraqet diagnozën më të raportuar të SKJN si për vitin 2023, ashtu edhe për vitin 2024. Më 2023 janë raportuar 20472 raste, ndërsa më 2024 janë raportuar 21425 raste.

Kjo tregon për një rritje prej 4.7% të rasteve të hipertensionit arterial me dominim të gjinisë femërore. Karakteristikat kryesore flasin për një dominim të fortë të rasteve pas moshës 50 vjeçe, respektivisht me dominim të grupmoshës 65-69 me 19.06% të rasteve më 2023 dhe 19.04% gjatë vitit 2024.

Prevalenca është dukshëm më e lartë te femrat, por meshkujt janë më të ekspozuar ndaj komplikimeve kardiale, si infarkti akut i miokardit.

3.2.2 Diabeti

Diabeti mellitus paraqet një nga problemet më serioze të shëndetit publik në Kosovë. Nga raportet e SKJN për vitet 2023 dhe 2024 vërehet ngritje e rasteve të Diabetit tip 2 (E11) nga 9723 raste në vitin 2023 në 11729 raste në vitin 2024.

Kjo është një rritje shumë e theksuar prej 20.6% që në fakt paraqet rritjen më alarmante ndër të gjitha diagnozat kryesore të sëmundjeve jo ngjitëse kronike në Kosovë.

Ndërsa, sa u përket rasteve të Diabetit tip 1 (E 10) vërehet një rënie relative e rasteve të raportuara në vitin 2024, nga 3410 raste në vitin 2023, në 2681 të raportuara në vitin 2024.

Kjo rënie mund të ketë ndodhur për shkak të strukturës së raportimit dhe peshës më të madhe të Diabetit tip 2 (E 11) në vitin 2024, ndonëse nuk mund të vërtetohet në mënyra automatike, me që diabeti tip 1 ka incidencë relativisht stabile në popullatë.

Rritja e diabetit tip 2 lidhet drejtpërdrejt me obezitetin, aktivitetin e ulët fizik, ushqyerjen jo të shëndetshme dhe urbanizimin. Ky trend paraqet rrezik të shtuar për komplikime afatgjata dhe kosto të larta shëndetësore.

Sa u përket grupmoshave, dominon ajo 65-69 vjeçe me 20,99% të rasteve për vitin 2023 dhe 19.63% për vitin 2024.

Karakteristikë që bie në sy është se Diabeti po shfaqet gjithnjë e më herët duke shënuar rritje në grupmoshat e reja.

Tabela 5: Rastet e Diabetit tip 2 (E 11) të raportuara për periudhën Janar -Dhjetor 2023 dhe Janar-Dhjetor 2024, sipas grupmoshave dhe gjinisë

Grup Moshë	Diabeti(E11)							
	2023				2024			
	Gjinia		N	%	Gjinia		N	%
	F	M			F	M		
0-4	-	1	1	0.01%	-	-	-	-
5-9	1	1	2	0.02%	3	8	11	0.09%
10-14	4	3	7	0.07%	10	10	20	0.17%
15-19	8	6	14	0.14%	18	22	40	0.34%
20-24	12	8	20	0.21%	27	23	50	0.43%
25-29	17	15	32	0.33%	19	18	37	0.32%
30-34	19	18	37	0.38%	29	37	66	0.56%
35-39	52	26	78	0.80%	37	41	78	0.67%
40-44	89	51	140	1.44%	98	71	169	1.44%
45-49	201	131	332	3.41%	162	137	299	2.55%
50-54	436	242	678	6.97%	431	261	692	5.90%
55-59	721	448	1169	12.02%	804	514	1318	11.24%
60-64	1063	655	1718	17.67%	1167	751	1918	16.35%
65-69	1245	796	2041	20.99%	1397	905	2302	19.63%
70-74	1067	671	1738	17.88%	1340	801	2141	18.25%
75-79	674	401	1075	11.06%	855	518	1373	11.71%
80+	412	223	635	6.53%	508	328	836	7.13%
Panjohur	4	2	6	0.06%	237	142	379	3.23%
Total	6025	3698	9723	100.00	7142	4587	11729	100.00

Tabela 6: Rastet e Diabetit tip 1 (E 10) të raportuara për periudhën Janar -Dhjetor 2023 dhe Janar-Dhjetor 2024, sipas grupmoshave dhe gjinisë

Grup Mosha	Diabeti (E10)							
	2023				2024			
	Gjinia		N	%	Gjinia		N	%
	F	M			F	M		
0-4	-	1	1	0.03%	3	2	5	0.19%
5-9	6	10	16	0.47%	4	3	7	0.26%
10-14	13	15	28	0.82%	19	12	31	1.16%
15-19	25	24	49	1.44%	19	18	37	1.38%
20-24	21	19	40	1.17%	16	27	43	1.60%
25-29	23	17	40	1.17%	15	12	27	1.01%
30-34	22	13	35	1.03%	19	12	31	1.16%
35-39	22	21	43	1.26%	20	21	41	1.53%
40-44	17	25	42	1.23%	15	30	45	1.68%
45-49	56	36	92	2.70%	42	33	75	2.80%
50-54	117	87	204	5.98%	81	62	143	5.33%
55-59	206	141	347	10.18%	153	107	260	9.70%
60-64	320	191	511	14.99%	226	162	388	14.47%
65-69	416	295	711	20.85%	329	204	533	19.88%
70-74	398	242	640	18.77%	297	200	497	18.54%
75-79	234	146	380	11.14%	189	133	322	12.01%
80+	140	87	227	6.66%	104	86	190	7.09%
Panjohur	1	3	4	0.12%	3	3	6	0.22
Totali	2037	1373	3410	100.00	1554	1127	2681	100.00

Sikurse edhe te Diabeti tip 2, edhe te Diabeti tip 1, grupmosha më e prekur është 65-69 vjeçe me 20.85% të rasteve më 2023 dhe 19.85 % të rasteve më 2024.

3.2.3 Sëmundjet iskemike të zezrës

Sa u përket Sëmundjeve iskemike të zezrës: Anginës Pektorale (I 20), Infarktut akut të miokardit (I 21) dhe Sëmundjes Iskemike të zezrës (I-25), vërehet një trend i rënies të Angina Pectorale, nga 1715 raste më 2023 në 403 raste më 2024, apo nga 4.2% në 1.1%; Një ngritje e rasteve të Infarktut akut të miokardit me 2366 raste (667 raste të femrat dhe 1699 raste të meshkujt) më 2024, krahasuar me 1800 raste më 2023; si dhe një rënie e sëmundjes iskemike të zezrës nga 1501 raste më 2023 në 268 raste më 2024. Nga raportet e Departamentit të Statistikave, vërehet se në vitin 2024 raportimi është më selektiv dhe i diferencuar për sëmundjet e zezrës sipas ICD.

Në vitin 2023 në rangun e diagnozave të sëmundjeve masovike jo ngjitëse janë përfshirë të diferencuara vetëm Angina Pectorale (I20) dhe sëmundje iskemike kronike e zezrës (I25), por jo edhe Infarkti akut i miokardit (I21), i cili në mënyrë më selektive dhe të diferencuar është përfshirë në raportin e SKJN për 2024. Infarkti akut i miokardit (I21) shënon rritje të konsiderueshme, kryesisht të meshkujt 50–69 vjeç dhe kjo sugjeron për diagnostikim më të mirë të ngjarjeve akute, por ngre edhe shqetësimin për dështim në parandalimin primar dhe sekondar.

Ndërsa, Angina pectoris dhe sëmundjet iskemike kronike karakterizohen, pra, me ulje relative, që mund të ndërlihet kryesisht me ndryshime në raportim dhe kodim në raportin e SKJN.

Të dhëna për sëmundjet iskemike të zezrës sugjerojnë nevojën për forcim të parandalimit primar dhe sekondar të sëmundjeve kardiovaskulare.

Tabela 7. Rastet e Sëmundjeve iskemike të zemrës (I20, I21, I25) të raportuara për periudhën Janar-Dhjetor 2024 sipas grup-moshës dhe gjinisë

Grup moshë	Gjinia	Angina pektorale (I20)		Infarkti akut i miokardit (I21)		Sëmundja iskemike kronike e zemrës (I25)		Totali (I20,I21,I25)	
		N	%	N	%	N	%	N	%
<20	F	-	-	-	-	-	-	-	-
	M	-	-	-	-	-	-	-	-
	Gj	-	-	-	-	-	-	-	-
20-39	F	4	1	16	0.7	1	0.4	21	0.7
	M	3	0.7	46	1.9	4	1.5	53	1.7
	Gj	7	1.7	62	2.6	5	1.8	74	2.4
40-59	F	49	12.2	172	7.3	29	10.7	250	8.2
	M	59	14.6	642	27.1	51	18.8	752	24.7
	Gj	108	26.8	814	34.4	80	29.5	1002	32.9
60+	F	154	38.2	477	20.2	70	25.8	701	23.1
	M	134	33.3	1002	42.3	115	42.4	1251	41.1
	Gj	288	71.5	1479	62.5	185	68.3	1952	64.2
Panjohur	F	-	-	2	0.1	1	0.4	3	0.1
	M	-	-	10	0.4	-	0	10	0.3
	Gj	-	-	12	0.5	-	0	12	0.4
Totali	F	207	51.4	667	28.2	101	37.3	975	32.1
	M	196	48.6	1700	71.8	170	62.7	2066	67.9
	Gj	403	100	2367	100	271	100	3041	100
	%	13.3		77.8		8.9		100	

3.2.4 Sëmundjet kronike respiratore

Sëmundjet kronike respiratore, përfshirë Bronkitin kronik dhe Sëmundjen Kronike Obstruktive të Mushkërive (COPD), shfaqin trend të rritjes në vitin 2024.

Sipas të dhënave të raportuara, rastet e bronkitit kronik (J42) kanë shënuar rritje nga 997 raste në vitin 2023 në 1164 raste në vitin 2024, që përfaqëson një rritje prej 167 rastesh, respektivisht një rritje relative prej 16.8% krahasuar me vitin paraprak.

Dominon grup-mosha 65-69 vjeçe me 15.3% të rasteve më 2023 dhe 15.5% të rasteve më 2024.

Kjo rritje sugjeron nevojën për analizë më të thelluar të faktorëve kontribues, përfshirë ekspozimin ndaj faktorëve të rrezikut si duhanpirja dhe ndotja e ajrit, si dhe vlerësimin e mundshëm të ndryshimeve në raportim dhe diagnostikim.

Në të njëjtën periudhë, rastet e raportuara të astmës bronkiale kanë shënuar rënie nga 477 raste në vitin 2023 në 369 raste në vitin 2024, që përfaqëson ulje prej 108 rastesh, respektivisht rënie relative prej 22.6%.

Megjithatë, kjo rënie duhet interpretuar me kujdes, pasi nga të dhënat aktuale nuk mund të konstatohet nëse përfaqëson reduktim real të incidencës së sëmundjes apo ndërlihet me faktorë të tjerë si ndryshime në praktikën diagnostike, nivelin e raportimit, qasjen në shërbime shëndetësore apo lëvizjet demografike.

Tabela 8. Rastet e Bronkitit kronik të paspecifikuar (J42), të raportuara për periudhën Janar-Dhjetor 2023, sipas grup-moshës dhe gjinisë

Grup Moshë	Bronkiti kronik, i paspecifikuar (J42)							
	2023				2024			
	Gjinia		N	%	Gjinia		N	%
	F	M			F	M		
0-4	-	-	-	-	5	5	10	0.9%
5-9	-	1	1	0.1%	2	1	3	0.3%
10-14	1	-	1	0.1%	1	2	3	0.3%
15-19	1	3	4	0.4%	3	9	12	1.0%
20-24	5	2	7	0.7%	4	7	11	0.9%
25-29	3	7	10	1.0%	3	9	12	1.0%
30-34	11	12	23	2.3%	4	5	9	0.8%
35-39	14	15	29	2.9%	14	13	27	2.3%
40-44	12	16	28	2.8%	24	20	44	3.8%
45-49	30	17	47	4.7%	37	35	72	6.2%
50-54	31	41	72	7.2%	46	34	80	6.9%
55-59	67	60	127	12.7%	66	51	117	10.0%
60-64	73	59	132	13.2%	94	61	155	13.3%
65-69	82	71	153	15.3%	88	93	181	15.5%
70-74	71	68	139	13.9%	85	82	167	14.3%
75-79	40	58	98	9.8%	64	58	122	10.5%
80+	69	56	125	12.5%	78	59	137	11.7%
Panjohur		1	1	0.1%	1	3	4	0.3%
Totali	510	487	997	100.0	619	547	1166	100.0

Tabela 9: Rastet e Astmës Bronkiale (J45), të raportuara për periudhën Janar-Dhjetor 2023 dhe Janar- Dhjetor 2024

Grup Mosha	Astma Bronkiale (J45)							
	2023				2024			
	Gjinia		N	%	Gjinia		N	%
	F	M			F	M		
0-4	29	24	53	11.1%	34	25	59	16.0%
5-9	7	17	24	5.0%	12	16	28	7.6%
10-14	8	5	13	2.7%	5	4	9	2.4%
15-19	2	7	9	1.9%	3	6	9	2.4%
20-24	4	4	8	1.7%	3	2	5	1.4%
25-29	4	8	12	2.5%	1	1	2	0.5%
30-34	4	5	9	1.9%	4	3	7	1.9%
35-39	10	3	13	2.7%	5	7	12	3.3%
40-44	9	4	13	2.7%	11	5	16	4.3%
45-49	14	7	21	4.4%	15	2	17	4.6%
50-54	25	9	34	7.1%	19	3	22	6.0%
55-59	33	13	46	9.6%	30	9	39	10.6%
60-64	32	17	49	10.3%	28	11	39	10.6%
65-69	20	18	38	8.0%	28	8	36	9.8%
70-74	29	24	53	11.1%	17	10	27	7.3%
75-79	28	24	52	10.9%	15	9	24	6.5%
80+	15	15	30	6.3%	9	7	16	4.3%
Panjohur	-	-	-	-	1	1	2	0.5%
Totali	273	204	477	100.0	240	129	369	100.0

Tabela 10. Rastet e Sëmundjeve të tjera obstruktive kronike të mushkërive (J44), të raportuara për periudhën Janar-Dhjetor 2024, sipas grup moshës dhe gjinisë

Sëmundjet tjera obstruktive kronike të mushkërive (J44)				
Grup Moshë	Gjinia		N	%
	F	M		
<5	13	16	29	4.9
5-9	1	6	7	1.2
10-14	1	3	4	0.7
15-19	-	1	1	0.2
20-24	1	1	2	0.3
25-29	1	1	2	0.3
30-34	-	4	4	0.7
35-39	1	5	6	1
40-44	10	8	18	3
45-49	6	5	11	1.9
50-54	16	15	31	5.2
55-59	21	22	43	7.3
60-64	36	46	82	13.8
65-69	33	62	95	16
70-74	31	66	97	16.4
75-79	37	41	78	13.2
80+	43	38	81	13.7
Panjohur	2	-	2	0.3
Totali	253	340	593	100

3.2.5 Insuficiencia kronike e veshkave

Raportet e Sëmundjeve Kronike Jo ngjitëse tregojnë se Insuficiencia kronike e veshkave (N18) si gjatë vitit 2023, ashtu edhe gjatë vitit 2024 është raportuar në mesin e dhjetë diagnozave më të shpeshta në kuadër të SKJN.

Rastet e insuficiencës kronike të veshkave (N18) kanë shënuar rritje të konsiderueshme, nga 703 raste në vitin 2023 në 1043 raste në vitin 2024, që përfaqëson një rritje absolute prej 340 rastesh, respektivisht rritje relative prej 48.4%. Në vitin 2023 dominonin rastet e gjinisë femërore me 54.2%, ndërsa në vitin 2024 vërehet pothuajse barazi gjinore, me rritje më të theksuar të rasteve tek meshkujt. Grup-mosha 70–74 vjeç mbetet më e prekur në të dy vitet, duke përbërë rreth një të pestën e rasteve totale.

Tabela 11. Rastet e Insuficiencës kronike të veshkëve (N18), të raportuara për periudhën Janar-Dhjetor 2023 dhe Janar-Dhjetor 2024, sipas grup-moshës dhe gjinisë

Grup Moshë	Insuficiencia Kronike e veshkave (N18)							
	2023				2024			
	Gjinia		N	%	Gjinia		N	%
	F	M			F	M		
0-4	-	-	-	-	-	-	-	-
5-9	-	-	-	-	-	-	-	-
10-14	-	-	-	-	-	-	-	-
15-19	-	-	-	-	2	-	2	0.19%
20-24	1	3	4	0.57%	2	4	6	0.58%
25-29	1	3	4	0.57%	1	5	6	0.58%
30-34	2	4	6	0.85%	8	10	18	1.73%
35-39	6	2	8	1.14%	7	4	11	1.05%
40-44	2	6	8	1.14%	7	9	16	1.53%
45-49	11	13	24	3.41%	13	18	31	2.97%
50-54	21	16	37	5.26%	30	28	58	5.56%
55-59	27	24	51	7.25%	32	41	73	7.00%
60-64	57	42	99	14.08%	53	60	113	10.83%
65-69	60	53	113	16.07%	94	98	192	18.41%
70-74	78	61	139	19.77%	100	95	195	18.70%
75-79	59	39	98	13.94%	95	88	183	17.55%
80+	56	56	112	15.93%	71	62	133	12.75%
Panjohur					4	2	6	0.58%
Totali	381	322	703	100.00	519	524	1043	100.00

3.2.6 Çrregullimet mendore

Sa i përket shëndetit mendor, sipas të dhënave raportuese që përfshijnë Skizofreninë (F20) dhe episode depresive të rënda (F32.3), vërehet ulje e numrit të rasteve të raportuara në vitin 2024.

Gjatë vitit 2023 janë raportuar 1063 raste të Skizofrenisë (F20), derisa më 2024 janë raportuar 627 raste.

Kurse, raste të episodës depresive të rëndë (F32.3) gjatë vitit 2023 janë raportuar 225, derisa më 2024 janë raportuar 185 raste.

Për vitin 2023, mosha dominuese e rasteve të Skizofrenisë është 45-49 vjeçe me 16.3% të rasteve, ndërsa më 2024, dominon grupmosha 40-44 vjeçe me 15.9% të rasteve.

Rënia e numrit të rasteve nuk nënkupton domosdoshmërisht përmirësim, dhe mund të lidhet me nën-raportim, ekspozim të rasteve ndaj fenomenit të stigmatizimit dhe orientimit të pacientëve drejt sektorit privat, ku mund të kenë më shumë privatësi.

Tabela 12: Rastet e Skizofrenisë (F20), të raportuara për periudhën Janar -Dhjetor 2023 dhe Janar-Dhjetor 2024, sipas grup-moshës dhe gjinisë

Grup Moshë	Skizofrenia (F20)							
	2023				2024			
	Gjinia		N	%	Gjinia		N	%
	F	M			F	M		
0-4	-	-	-	-	-	-	-	-
5-9	-	-	-	-	-	-	-	-
10-14	-	-	-	-	-	-	-	-
15-19	5	4	9	0.8%	-	-	-	-
20-24	12	27	39	3.7%	4	10	14	2.2%
25-29	14	37	51	4.8%	7	17	24	3.8%
30-34	11	42	53	5.0%	8	22	30	4.8%
35-39	34	54	88	8.3%	13	40	53	8.5%
40-44	57	96	153	14.4%	43	57	100	15.9%
45-49	66	107	173	16.3%	38	57	95	15.2%
50-54	65	94	159	15.0%	39	51	90	14.4%
55-59	71	77	148	13.9%	40	40	80	12.8%
60-64	33	71	104	9.8%	29	43	72	11.5%
65-69	19	26	45	4.2%	16	27	43	6.9%
70-74	9	16	25	2.4%	9	6	15	2.4%
75-79	3	3	6	0.6%	4	3	7	1.1%
80+	-	2	2	0.2%	1	-	1	0.2%
Panjohur	2	6	8	0.8%	1	2	3	0.5%
Totali	401	662	1063	100.0	252	375	627	100.0

3.3. Shpërndarja gjeografike e rasteve

Krahasimi i të dhënave të rasteve të SKJN për periudhën Janar–Dhjetor 2023 dhe Janar-Dhjetor 2024 sa i përket dimensionit gjeografik apo shpërndarjes së rasteve nëpër komuna, tregon variacione të theksuara.

Shpërndarja territoriale tregon një koncentrim të konsiderueshëm të rasteve në disa komuna të mëdha urbane, me dallime të qarta midis viteve.

Bazuar në të dhënat e raportuara, Gjakova ka një rritje të theksuar dhe disproporcionale, duke shënuar rritjen më të madhe absolute dhe relative. Numri i rasteve është rritur nga 6428 në 8583, duke e rritur pjesëmarrjen në totalin nacional nga 15.6% në 19.7% të rasteve.

Kjo rritje është dukshëm më e lartë se trendi mesatar i komunave të tjera të mëdha dhe sugjeron se mund të ketë përmirësim të ndjeshëm të raportimit, rritje reale të incidencës, strukturë më të madhe të popullsisë së moshuar apo kombinim të këtyre faktorëve.

Prishtina paraqet stabilitet në nivel të lartë sa u përket rasteve. Numri i rasteve mbetet relativisht stabil: 4 253 raste në vitin 2023 kundrejt 4222 rasteve në vitin 2024.. Ky stabilitet mund të interpretohet si sistem raportimi më i konsoliduar, qasje më e mirë në procedurat diagnostike dhe strukturë urbane me mbulim më të mirë të shërbimeve.

Mitrovica shënon rritje graduale apo të moderuar, nga 3048 raste më 2023 në 3277 raste më 2024, kryesisht e lidhur me grupmoshën 60+. Kjo sugjeron një trend të qëndrueshëm të sëmundjeve kronike, në përputhje me plakjen demografike.


Kurse komunat me rënie relative janë Ferizaj dhe Prizreni, ku vihet re një rënie e lehtë e rasteve, që shkon në favor të stabilizimit të incidencës apo luhatjeve në raportim.

Përveç numrit absolut të rasteve, analiza e shpërndarjes territoriale është realizuar edhe sipas incidencës për 100,000 banorë, e cila reflekton më saktë pasqyrën relative të sëmundjeve në raport me madhësinë e popullsisë. Në vitin 2023, incidenca më e lartë është regjistruar në komunat Zubin Potok (41,713 raste për 100,000 banorë), Shtërpcë (18,345 për 100,000 banorë), Obiliq (13,359 për 100,000 banorë), Kaçanik (8,767 për 100,000 banorë) dhe Gjilan (7,746 për 100,000 banorë). Këto komuna paraqesin numër dukshëm më të lartë të sëmundjeve krahasuar me komunat e tjera.


Në vitin 2024, incidenca më e lartë vazhdon të raportohen në Zubin Potok (46,558 raste për 100,000 banorë), Obiliq (14,363 për 100,000 banorë), Gjakovë (10,906 për 100,000 banorë) dhe Shtërpcë (9,729 për 100,000 banorë). Krahasuar me vitin paraprak, në disa komuna vërehet rritje e dukshme e incidencës, veçanërisht në Gjakovë dhe Obiliq, ndërsa në disa të tjera vërehet stabilizim ose ulje relative.

Sa i përket dimensionit të moshës, analiza sipas grupmoshave konfirmon se sëmundjet jo-ngjitëse dominohen nga grupmosha 60+, e cila përbën mbi 70% të rasteve në të dy vitet.


Rritja nga 28 569 raste (2023) në 30633 raste (2024) në këtë grupmoshë është faktori kryesor që kontribuon në rritjen totale të rasteve në nivel nacional. Në grupmoshën 40–59 vihet re stabilitet relativ, ndërsa në 20–39 një rënie e lehtë, që mund të lidhet me migrim ose ndryshime demografike.




Grafiku 4. Rangu i rasteve me Sëmundje Kronike Jongjitëse sipas komunave të vendbanimit



Grafiku 5. Rangu i rasteve me Sëmundje Kronike Jongjitëse sipas komunave të vendbanimit



Harta 1: Incidenca e Sëmundjeve Kronike Jongjitetë sipas komunave në Kosovë, Janar–Dhjetor 2023



Harta 2: Incidenca e Sëmundjeve Kronike Jongjitetë sipas komunave në Kosovë, Janar–Dhjetor 2024

4. SËMUNDJET MALINJE

Të dhënat e regjistruara në Raportin e statistikave shëndetësore-Raporti i Sëmundjeve malinje për periudhën janar-dhjetor 2023 dhe Raporti i Sëmundjeve malinje për periudhën Janar-Dhjetor 2024, tregojnë se sëmundjet malinje vazhdojnë të përbëjnë një problematikë të rëndësishme për shëndetin publik në Kosovë. Gjatë vitit 2023 janë regjistruar 4165 raste të reja të sëmundjeve malinje me incidencë 236.4/100000, ndërsa në vitin 2024 janë regjistruar 3644 raste të reja me incidencë 206.8/100000, duke shënuar një ulje prej rreth 12.5% të incidencës.


Tabela 13: Incidenca dhe prevalenca e sëmundjeve malinje për vitin 2023 dhe 2024

Viti	Incidenca/100,000 banorë	Prevalenca/ 100,000 banorë
2023	236.4	283.6
2024	206.8	262.2


Shpërndarja sipas gjinisë është pothuajse e balancuar në të dy vitet, megjithëse në vitin 2024 vërehet një përqindje pak më e lartë e rasteve të reja (incidenca) tek femrat (51.8%) krahasuar me meshkujt (48.2%). Sa i përket prevalencës, në vitin 2023 janë regjistruar 4997 raste në total, ndërsa në vitin 2024 janë regjistruar 4620 raste, që paraqet një ulje prej rreth 7.5%. Femrat përbëjnë pjesën më të madhe të rasteve në të dy vitet (rreth 54.7%), çka lidhet kryesisht me dominimin e kancerit të gjirit dhe mbijetesën më të gjatë në krahasim me disa lloje të tjera të kancerit, më të shprehura te gjinia mashkullore si kanceri i lëkurës dhe kanceri kolorektal.

Tabela 14: Struktura e rasteve të reja dhe në total sipas gjinisë

Viti	Kategoria	Femra n (%)	Meshkuj n (%)	Gjithsej
2023	Raste të reja	2085 (50.1%)	2080 (49.9%)	4165
2023	Të gjitha rastet	2735 (54.7%)	2262 (45.3%)	4997
2024	Raste të reja	1886 (51.8%)	1758 (48.2%)	3644
2024	Të gjitha rastet	2546 (55.1%)	2074 (44.9%)	4620




Grafiku 6: Incidenca dhe prevalenca e sëmundjeve malinje në Kosovë 2023-2024




Grafiku 7 dhe 8. Përqindja e rasteve të reja sipas gjinisë 2023 vs 2024

2023



2024




Grafiku 9 dhe 10. Përqindja e total rasteve sipas gjinisë 2023 vs 2024

Tabela 15. Rastet e reja të raportuara për periudhën Janar-Dhjetor 2023 sipas grupeve diagnozave


Grupet e diagnozave malinje	Gjinia				Gjithsej	
	Femer		Mashkull			
	N	%	N	%	N	%
Tumoret malinje të buzës, zgavrës së gojës dhe faringut (C00-C14)	36	1.7	53	2.5	89	2.1
Tumoret malinje të organeve të tretjes (C15- C26)	338	16.2	440	21.2	778	18.7
Tumoret malinje të organeve të frymëmarrjes dhe organeve intratorakale (C30-C39)	89	4.3	355	17.1	444	10.7
Tumoret malinje të kockave dhe nyjeve (C40-C41)	8	0.4	4	0.2	12	0.3
Melanoma dhe neoplazmat malinje të tjera të lëkurës (C43-C44)	259	12.4	465	22.4	724	17.4
Tumoret malinje të indeve të buta mesotheliale (C45-C49)	20	1	24	1.2	44	1.1
Neoplazma malinje e gjirit (C50-C50)	617	29.6	6	0.3	623	15
Tumoret malinje të organeve gjenitale femërore (C51-C58)	403	19.3			403	9.7
Tumoret malinje të organeve gjenitale mashkullore (C60-C63)			267	12.8	267	6.4
Tumoret malinje të traktit urinar C64-C68)	73	3.5	265	12.7	338	8.1
Tumoret malinje të syri trurit dhe pjesë të tjera të sistemit nervor qendror (C69-C72)	100	4.8	101	4.9	201	4.8
Tumoret malinje të tiroides dhe gjëndra të tjera endokrine (C73-C75)	71	3.4	17	0.8	88	2.1
Tumoret malinje të pjesëve të paspecifikuara (C76-C80)	23	1.1	25	1.2	48	1.2
Tumoret malinje primar të indeve limfoide, haematopoietike dhe të indeve të lidhura (C81- C96)	44	2.1	55	2.6	99	2.4
Tumoret malinje me lokalizime te ndryshme primare(C97-C97)			1	0.05	1	0.02
Neoplazma in situ (D00-D09)	3	0.1	1	0	4	0.1
Tumoret beninje (D10-D36)			1	0	1	0
Neoplazma me tipare te pacakuara dhe te panjohura(D37-D48)	1	0.05			1	0.02
TOTALI	2085	100	2080	100	4165	100

Tabela 16. Rastet e reja të raportuara për periudhën Janar-Dhjetor 2024 sipas grupeve të diagnozave dhe gjinisë

Grupet e diagnozave malinje	Gjinia				Gjithsej	
	Femer		Mashkull		N	%
	N	%	N	%		
Tumoret malinje të buzës, zgavrës së gojës dhe faringut (C00-C14)	28	1.5%	41	2.3%	69	1.9%
Tumoret malinje të organeve të tretjes (C15- C26)	290	15.4%	380	21.6%	670	18.4%
Tumoret malinje të organeve të frymëmarrjes dhe organeve intratorakale (C30-C39)	76	4.0%	304	17.3%	380	10.4%
Tumoret malinje të kockave dhe nyjeve (C40-C41)	5	0.3%	12	0.7%	17	0.5%
Melanoma dhe neoplazmat malinje të tjera të lëkurës (C43-C44)	201	10.7%	386	22.0%	587	16.1%
Tumoret malinje të indeve të buta mesotheliale (C45-C49)	25	1.3%	27	1.5%	52	1.4%
Neoplazma malinje e gjirit (C50-C50)	633	33.6%	7	0.4%	640	17.6%
Tumoret malinje të organeve gjentiale femërore (C51-C58)	364	19.3%	-	-	364	10.0%
Tumoret malinje të organeve gjentiale mashkullore (C60-C63)	-	-	238	13.5%	238	6.5%
Tumoret malinje të traktit urinar (C64-C68)	68	3.6%	192	10.9%	260	7.1%
Tumoret malinje të syri trurit dhe pjesë të tjera të sistemit nervor qendror (C69-C72)	88	4.7%	84	4.8%	172	4.7%
Tumoret malinje të tiroides dhe gjëndra të tjera endokrine (C73-C75)	48	2.5%	15	0.9%	63	1.7%
Tumoret malinje të pjesëve të paspecifikuara (C76-C80)	22	1.2%	24	1.4%	46	1.3%
Tumoret malinje primar të indeve limfoide, haematopietike dhe të indeve të lidhura (C81- C96)	36	1.9%	45	2.6%	81	2.2%
Tumoret malinje me lokalizime te ndryshme primare(C97-C97)	-	-	-	-	-	-
Neoplazma in situ (D00-D09)	-	-	-	-	-	-
Tumoret beninje (D10-D36)	-	-	1	0.1	1	0.03%
Neoplazma me tipare te pacakuara dhe te panjohura(D37-D48)	2	0.1%	2	0.1	4	0.1%
TOTALI	1886	100.0	1758	100.0	3644	100.0



Grafiku 11 . Rastet e reja të raportuara për periudhën Janar-Dhjetor 2023 sipas grup-moshës dhe gjinis



Grafiku 12. Rastet e reja të raportuara për periudhën Janar-Dhjetor 2024 sipas grupmoshave dhe gjinisë

Gjatë krahasimit të numrit të rasteve të reja vërehet një rritje e numrit të rasteve të gjinisë fenërore për 10.5 % në vitin 2024, ndërkah vërehet një rritje e numrit të rasteve të gjinisë mashkullore për 18.31% në vitin 2024.

Analiza e diagnozave kryesore tregon se kanceri i gjirit është diagnoza më e shpeshtë tek femrat si në vitin 2023 ashtu edhe në vitin 2024, me 617 raste të reja (2023), përkatësisht 633 raste (2024) duke përfaqësuar një pjesë të konsiderueshme të rasteve të reja dhe të rasteve totale. Pas tij renditen tumoret e organeve gjenitale femërore dhe tumoret e sistemit tretës.

Tek meshkujt dominojnë tumoret e lëkurës (melanoma dhe të tjera), me 465 raste të reja në vitin 2023 dhe 386 raste të reja në vitin 2024, pasuar nga tumoret e organeve të tretjes dhe tumoret e sistemit respirator, të cilat shpesh lidhen me faktorë të stilit të jetesës si duhanpirja, dieta dhe ekspozimi ndaj faktorëve të mjedisit.

Sipas grupmohave, shumica e rasteve të sëmundjeve malinje paraqiten në moshat mbi 50 vjeç, me rritje të dukshme të incidencës në grupmoshat 50–69 dhe mbi 70 vjeç. Në mënyrë specifike, numri më i madh i rasteve të reja për vitin 2023 është regjistruar të grupmosha 65-69 vjeç, gjithsejt 684 raste apo 16.4% të gjitha rasteve. Sikurse edhe gjatë vitit 2024, ku numri më i madh i rasteve është po te kjo grupmoshë me 556 raste apo 15.3% të gjitha rasteve të reja. Kjo reflekton lidhjen e fortë të kancerit me plakjen e popullsisë dhe rritjen e jetëgjatësisë.

Tabela 17: Rastet e reja të pesë diagnozave më të shpeshta të sëmundjeve malinje te femrat 2023

Diagnoza	ICD-10	2023		2024	
		N	%	N	%
Neoplazma malinje e gjirit	C50-C50	617	29.60%	633	33.50%
Tumoret malinje të organeve gjenitale femërore	C51-C58	403	19.30%	364	19.30%
Tumoret malinje të organeve të tretjes	C15-C26	338	16.20%	290	15.40%
Melanoma dhe neoplazmat malinje të lëkurës	C43-C44	259	12.40%	201	10.60%
Tumoret malinje të syrit, trurit dhe SNQ	C69-C72	100	4.80%	88	4.70%

Tabela 18: Rastet e reja të pesë diagnozave më të shpeshta të sëmundjeve malinje te meshkujt 2023

Diagnoza	ICD-10	2023		2024	
		N	%	N	%
Melanoma dhe neoplazmat malinje të lëkurës	C43-C44	465	22.40%	386	21.90%
Tumoret malinje të organeve të tretjes	C15-C26	440	21.20%	380	21.60%
Tumoret malinje të org. frymëmarrjes dhe intratorakale	C30-C39	355	17.10%	304	17.30%
Tumoret malinje të organeve gjenitale mashkullore	C60-C63	267	12.80%	238	13.50%
Tumoret malinje të traktit urinar	C64-C68	265	12.70%	192	10.90%


Tabela 19: Të gjitha rastet e pesë diagnozave më të shpeshta të sëmundjeve malinje te femrat për vitin 2024

Diagnoza	ICD-10	2023		2024	
		N	%	N	%
Neoplazma malinje e gjirit	C50-C50	1093	40.00%	1088	42.70%
Tumoret malinje të organeve gjenitale femërore	C51-C58	477	17.40%	433	17.00%
Tumoret malinje të organeve të tretjes	C15-C26	381	13.90%	340	13.40%
Melanoma dhe neoplazmat malinje të lëkurës	C43-C44	264	9.70%	218	8.60%
Tumoret malinje të org. frymëmarrjes dhe intratorakale	C30-C39	106	3.90%	95	3.70%


Tabela 20: Të gjitha rastet e pesë diagnozave më të shpeshta sëmundjeve malinje te meshkujt për vitin 2024

Diagnoza	ICD-10	2023		2024	
		N	%	N	%
Melanoma dhe neoplazmat malinje të lëkurës	C43-C44	491	21.70%	438	21.10%
Tumoret malinje të organeve të tretjes	C15-C26	480	21.20%	428	20.60%
Tumoret malinje të org. frymëmarrjes dhe intratorakale	C30-C39	398	17.60%	373	18.00%
Tumoret malinje të organeve gjenitale mashkullore	C60-C63	298	13.20%	299	14.40%
Tumoret malinje të traktit urinar	C64-C68	290	12.80%	231	11.10%

Nga aspekti i shtrirjes gjeografike, numri më i madh i rasteve është regjistruar në komunat më të mëdha të vendit, si Prishtina, Prizreni, Peja, Gjakova dhe Ferizaj, gjë që lidhet me madhësinë e popullsisë, qasjen më të mirë në shërbime diagnostike dhe raportimin më të plotë të rasteve.




Grafiku 13. Rangu i rasteve të reja me sëmundje malinje sipas komunave të vendbanimit për periudhën Janar-Djhetor 2023 në total



Grafiku 14. Rangu i rasteve të reja me sëmundje malinje sipas komunave të vendbanimit për periudhën Janar-Djhetor 2024 në total

Sa i përket vitit 2023, në IKSHPK për sëmundje malinje kanë raportuar 33 komuna, ndërsa 33 raste janë regjistruar si e “panjohur” komuna e raportimit. Numri më i madh i rasteve të raportuara janë nga Prishtina, 963 raste apo 23.1%; Prizreni 416 raste apo 10%; Peja 243 raste apo 6.2%; Gjakova 243 raste apo 5.8%, pasuar nga Ferizaj me 211 raste apo 5.1% dhe Mitrovica me 207 raste apo 5.0%.

Përveç numrit absolut të rasteve, shpërndarja gjeografike është analizuar edhe sipas incidencës për 100,000 banorë, e cila jep një pasqyrë më të saktë të rasteve të sëmundjeve malinje në raport me madhësinë e popullsisë. Në vitin 2023, incidenca më e lartë është regjistruar në komunën e Prishtinës (511 raste për 100,000 banorë), pasuar nga Mitrovica (384 për 100,000 banorë), Peja (369 për 100,000 banorë), Gjakova (368 për 100,000 banorë) dhe Obiliqi (346 për 100,000 banorë). Vlera relativisht të larta të incidencës janë vërejtur gjithashtu në komunat Vushtrri, Suharekë dhe Prizren.




Harta 3: Incidenca e Sëmundjeve Malinje në Kosovë për vitin 2023

Sa i përket vitit 2024, në IKSHPK për sëmundje malinje kanë raportuar 34 komuna, ndërsa 6 raste janë regjistruar si e “panjohur” komuna e raportimit. Numri më i madh i rasteve të raportuara janë nga Prishtina, 768 raste apo 21.1%; Prizreni 433 raste apo 11%; Peja 208 raste apo 5.7%; Gjakova 207 raste apo 5.7% < pasuar nga ferizaj me 193 raste apo 5.3%. Rastet e tjera janë shpërndarë nëpër komunat e tjera që kanë raportuar.

Në vitin 2024, incidenca më e lartë vazhdon të regjistrohet në Prishtinë (338 raste për 100,000 banorë), pasuar nga Prizreni (294 për 100,000 banorë), Mitrovica (266 për 100,000 banorë), Gjakova (263 për 100,000 banorë) dhe Peja (251 për 100,000 banorë). Krahasuar me vitin paraprak, në shumicën e komunave vërehet një ulje e lehtë e incidencës, ndërsa shpërndarja territoriale mbetet relativisht e ngjashme, me përqendrim më të madh të rasteve në komunat urbane dhe me popullsi më të madhe.

Në përgjithësi, analiza e incidencës sipas komunave tregon se sëmundjet malinje nuk shpërndahet në mënyrë uniforme në territor, por është më e theksuar në disa komuna specifike. Kjo mund të lidhet me faktorë demografikë, strukturën e popullsisë sipas moshës, qasjen në shërbime diagnostike dhe kapacitetet e raportimit në nivel lokal.



Harta 4: Incidenca e Sëmundjeve Malinje në Kosovë për vitin 2024


Shënim: Harta u referohet të dhënave të grumbulluara nga 35 komuna të cilat kanë raportuar sëmundjet malinje në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.

Në këta raport analitik janë analizuar edhe numri i përgjithshëm i rasteve të reja të kancerit për periudhën 2012-2024, për të parë ndryshimet rreth incidencës.

Nga të dhënat e regjistruara nga Departamenti i Statistikave të IKSHPK-së, rezulton se numri më i madh i rasteve është regjistruar në vitin 2014, 2017 dhe pas vitit 2021, kur për çdo vit numri ka kaluar në mbi 3000 raste të reja, me numrin më ta lartë të regjistruar të rasteve në vitin 2023, kur gjithsejt janë regjistruar 4165 raste të reja të sëmundjeve malinje në Kosovë. Ndryshimet relativisht të mëdha në numrin e rasteve të reja të sëmundjeve malinje gjatë viteve të analizuara mund të reflektojnë një kombinim faktorësh.

Njëra ndër arsyt kryesore mund të jetë përmirësimi i raportimit dhe regjistrimit të rasteve nga institucionet shëndetësore, përfshirë diagnostikimin më të mirë dhe raportimin më të mirë. Kjo mund të çojë në rritje të numrit të rasteve të regjistruara, pa nënkuptuar domosdoshmërisht rritje të menjëhershme të incidencës reale në popullatë. Nga ana tjetër, rritja e numrit të rasteve në vitet e fundit mund të lidhet edhe me faktorë demografikë dhe epidemiologjikë, si plakja e popullsisë, ekspozimi i vazhdueshëm ndaj faktorëve të rrezikut (si duhani, dieta jo e shëndetshme dhe stili sedentar i jetesës), si dhe përmirësimi i mundësive diagnostike.

Po ashtu, pas periudhës së pandemisë COVID-19 mund të jetë vërejtur një rritje e rasteve të diagnostikuara si rezultat i vonesave në diagnostikim gjatë viteve 2020–2021 dhe identifikimit të rasteve të akumuluar në vitet pasuese.



Grafiku 15. Rastet e reja të sëmundjeve malinje (incidenca) në Kosovë në periudhën 2012-2024

5. DISKUTIMI

Raporti i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2025 nxjerr në pah sfidat globale të shëndetit, ku në 2021, rreth 18 milionë njerëz nën moshën 70 vjeç vdiqën nga SKJN në nivel global – duke përfaqësuar më shumë se gjysmën e të gjitha vdekjeve të parakohshme. Rreziku i vdekjes së parakohshme midis moshës 30-70 vjeç nga një prej katër SKJN kryesore (sëmundjet kardiovaskulare, kanceri, diabeti ose sëmundjet respiratore kronike) u ul nga 22.5 për qind në 2000 në 18.4 për qind në 2015 dhe 18.0 për qind në 2019. Megjithatë, përparimi u ndalua gjatë 2020-2021 në vendet me të dhëna të besueshme. Nëse trendet para 2019 rifillojnë, rreziku i vdekjes së parakohshme parashikohet të bjerë në 16.3 për qind deri në 2030. As bota apo rajonet e saj nuk janë në rrugën e duhur për të arritur targetin e SDG 3.4 të reduktimit me një të tretën të vdekshmërive të parakohshme nga SKJN deri në 2030. Gratë përballen me rrezik më të ulët vdekjeje të parakohshme nga SKJN sesa burrat, në 2019.

Gjatë dy dekadave të fundit, prevalenca globale e përdorimit të duhanit është ulur me një të tretën, me rreth 118 milionë përdorues duhani më pak sot sesa në 2005. Pavarësisht këtij përparimi, rreth 1.25 miliardë njerëz përdorin ende duhan në nivel global, dhe përdorimi i duhanit mbetet një nga faktorët kryesorë të parandalueshëm të rrezikut për SKJN. Vetëm 56 vende ishin në rrugën e duhur për të arritur targetin e reduktimit me 30 për qind të prevalencës midis 2010 dhe 2025, sipas Planit Global të Veprimit të OBSH-së për Parandalimin dhe Kontrollin e SKJN-ve..

Analiza e raporteve për vitet 2023–2024 konfirmon se SKJN përbëjnë sfidën kryesore shëndetësore në Kosovë. Rritja e diabetit tip 2 dhe ngjarjeve kardiovaskulare akute tregon nevojën për qasje gjithëpërfshirëse, që tejkalon trajtimin klinik dhe fokusohet në parandalim, promovim të shëndetit dhe politika ndërsektoriale. Sëmundjet malinje përbëjnë gjithashtu një komponent të rëndësishëm të sëmundjeve jo-ngjitëse dhe kërkon vëmendje të veçantë në aspektin e diagnostikimit të hershëm dhe trajtimit.

Cilësia e të dhënave mbetet një sfidë e madhe me që raportimi ende nuk zhvillohet përmes një sistemi digjital të mbledhjes së të dhënave, ndërsa shumica e institucioneve shëndetësore në Kosovë nuk i kanë raportuar sëmundjet masovike jo ngjitëse, që pasqyrohet edhe me rritjen e kategorisë “panjohur” në vitin 2024 (nga 38 në 450 raste). Në raportim kjo tregon për mangësi në plotësimin e formularëve, nevojë për standardizim të raportimit dhe domosdoshmëri për trajnime shtesë të stafit raportues me që cilësia e të dhënave është thelbësore për analizë të saktë epidemiologjike dhe planifikim strategjik. Në përgjithësi, të dhënat theksojnë nevojën edhe për forcimin e programeve të parandalimit dhe zbulimit të hershëm të kancerit, veçanërisht për kancerin e gjirit, kancerin e qafës së mitrës, kancerin kolorektal dhe kanceret e lëkurës si dhe për ndërhyrje të vazhdueshme në faktorët e rrezikut si duhanpirja dhe mënyra e jetesës.

Gjithashtu, mbetet e rëndësishme përmirësimi i mëtejshëm i sistemit të regjistrimit dhe monitorimit të sëmundjeve malinje për të siguruar planifikim më të mirë të politikave shëndetësore në Kosovë.

6. KONKLUZIONE

Të dhënat e analizuara sugjerojnë se:

- Sëmundjet kronike jo-ngjitëse në Kosovë janë në rritje dhe se SKJN janë problemi më dominant shëndetësor në Kosovë me trend në rritje
- Hipertensioni dhe Diabeti tip 2 janë diagnozat dominuese në nivel nacional
- Diabeti tip 2 paraqet rritjen më alarmante ndër të gjitha diagnozat kryesore të SKJN
- Rastet e Sindromës akute kardiake po rriten, sidomos te gjinia mashkullore
- Sëmundjet malinje po bëhen gjithnjë e më shumë problematikë e madhe për shëndetësinë në Kosovë, sidomos kanceri i gjirit, kanceret e organeve gjenitale, të lekurës, kanceri kolorektal dhe kanceret e traktit respirator
- Ekziston nevojë urgjente për parandalim primar
- Faktori kryesor mbetet plakja e popullsisë
- Ekzistojnë dallime të konsiderueshme ndërmjet komunave dhe rritja e rasteve është e përqendruar territorialisht në disa komuna specifike
- Kujdesi parësor shëndetësor ka rol kyç në identifikimin dhe menaxhimin e SKJN
- Raportimi nuk është i plotë dhe duhet standardizuar e avancuar drejt një sistemi digjital

7. REKOMANDIME

6.1 Në nivel strategjik

- Përditësimi dhe zbatimi i Planit për parandalimin dhe kontrollin e Sëmundjeve Kronike Jongjitëse
- Të përafrohemi me targetin e SDG 3.4 të reduktimit me një të tretën të vdekshmërive të parakohshme nga SKJN deri në 2030
- Hartimi dhe zbatimi i Planit për parandalimin dhe kontrollin e kancerit me fokus kancerin e gjirit, të qafës së mitrës dhe kancerin kolorektal
- Zbatimi i politikave për kontrollin e duhanit, ushqyerjen e shëndetshme dhe aktivitetin fizik.

6.2 Në nivel të kujdesit parësor

- Zbatimi i skringut sistematik për hipertension dhe diabet
- Forcimi i kujdesit parësor për menaxhimin afatgjatë të sëmundjeve kronike jongjitëse
- Standardizimi i raportimit në të gjitha komunat dhe krijimi nga MSH-IKSHPK i regjistrit elektronik për SKJN, i ngjashëm sikurse për sëmundjet ngjitëse (SMSN)
- Përforcimi i sistemit të mbikëqyrjes dhe raportimit për sëmundjet kronike dhe sëmundjet malinje, me qëllim sigurimin e të dhënave më të sakta për planifikim dhe vendimmarrje në shëndetësi

6.3 Në nivel të komunitetit

- Fushata për zbatimin e Ligjit për Kontrollin e Duhanit
- Zbatimi i Planit për të ushqyerit e shëndetshëm dhe fushata për reduktimin e konsumit e kripës
- Promovimi i aktivitetit fizik
- Edukim i vazhdueshëm për faktorët e rrezikut

8. PËRFUNDIMI

Sëmundjet kronike jo-ngjitëse paraqesin sfidën më të madhe për shëndetin publik në Kosovë. Rritja e raportimit gjatë periudhës 2023–2024 kërkon reagim të koordinuar institucional, me fokus në parandalim, zbulim të hershëm dhe menaxhim afatgjatë.

Forcimi i sistemit të monitorimit dhe përdorimi i të dhënave për politikëbërje të bazuar në evidencë do të jenë thelbësore për reduktimin e incidencës dhe prevalencës së SKJN në vitet në vijim.

Në të njëjtën kohë, është e domosdoshme të intensifikohen ndërhyrjet në faktorët kryesorë të rrezikut si duhanpirja, ushqyerja jo e shëndetshme, mungesa e aktivitetit fizik dhe obeziteti.

Kjo kërkon bashkëpunim ndërsektorial, përfshirë sektorin e arsimit, pushtetin lokal dhe komunitetin, me qëllim promovimin e stileve të shëndetshme të jetesës dhe rritjen e ndërgjegjësimit të popullatës.

Gjithashtu, përmirësimi i cilësisë së raportimit dhe funksionalizimi i plotë i regjistrave të sëmundjeve kronike do të ndihmojnë në identifikimin më të saktë të trendeve dhe në planifikimin më efektiv të ndërhyrjeve shëndetësore.

Vetëm përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, të bazuar në parandalim, monitorim të vazhdueshëm dhe politika të qëndrueshme shëndetësore, mund të arrihet ulja graduale e sëmundjeve kronike jo-ngjitëse në Kosovë.

Shënim: Disa nga tabelat dhe grafikët e përdorur në këtë raport janë marrë nga Vjetarët statistikorë të Departamentit të Statistikave Shëndetësore dhe të tjerat janë punuar nga Divizioni i Sëmundjeve Jongjitëse i Departamentit të Epidemiologjisë të IKSHPK-së

9. REFERENCA

1. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK). Departamenti i Statistikave Shëndetësore. Vjetari i Statistikave Shëndetësore – Raporti i Sëmundjeve Jo ngjitëse Masovike për periudhën janar–dhjetor 2023. Prishtinë, Tetor 2024.
2. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK). Departamenti i Statistikave Shëndetësore. Vjetari i Statistikave Shëndetësore – Raporti i Sëmundjeve Jo ngjitëse Masovike për periudhën janar–dhjetor 2024. Prishtinë, Tetor 2025.
3. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK). Analiza e Sëmundjeve Jo ngjitëse Masovike. Prishtinë, 2024.
4. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK). Regjistri i Sëmundjeve Kronike (Masovike) Jongjitëse – Doracaku për paraqitjen e Sëmundjeve Kronike (Masovike) Jongjitëse. Prishtinë.
5. World Health Organization (WHO). Noncommunicable diseases progress monitor 2025. Geneva: WHO; 2025.
6. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK). Raport i Statistikave Shëndetësore- Raporti i Sëmundjeve Maline për periudhën Janar-Dhjetor 2023, Qershor 2024
7. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK). Raport i Statistikave Shëndetësore- Raporti i Sëmundjeve Maline për periudhën Janar-Dhjetor 2024, Mars 2025
8. United Nations Department of Economic and Social Affairs. (2025). *The Sustainable Development Goals Report 2025*. United Nations. <https://unstats.un.org/sdgs/report/2025/>